



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:100952

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05491031

CP.nr.935/2013

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Fuad Haliti dhe me bashkëpunëtorin profesional Eron Prekazi, në çështjen përmbare CP.nr.935/2013, të kreditorit G.T, me adresë në rr.”O” nr., kundër debitorit D.M, me vendbanim në fshatin Zerovnica, Komuna e Zveçanit, lidhur me pagesën e borxhit në shumën prej 1,000.00€, sipas aktvendimit të Gjykatës Komunale të Mitrovicës E.nr.494/05 të datës 29.05.2007, jashtë seancës gjyqësore, me datën 22.03.2024, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

Propozimi për përmbare i kreditorit G.T, ndaj debitorit D.M, konsiderohet se është **TËRHEQUR**, meqenëse kreditori nuk ka vepruar konform udhëzimeve të dhëna me konkluzionin CP.nr.935/2013 të datës 18.10.2023.

Arsyetim

Kreditori, G.T, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbaremit kundër debitorit D.M dhe kjo çështje me aktvendimin e Gjykatës së Apelit CA.nr.956/2012 i datës 22.04.2023, është kthyer në rivendosje.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me konkluzionin e datës 18.12.2023, ka obliguar kreditoren që në afat prej 3 ditësh nga momenti i pranimit të këtij konkluzioni, gjykatës t’ia sigurojë adresën e saktë dhe numrin personal të debitorit.

Kreditori, edhe pas pranimit të rregullt të këtij konkluzioni në bazë të afishimit në tabelë të shpalljeve, nuk ka vepruar komfor konkluzionit të datës 18.10.2023.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoi se mungon adresa e debitorit, andaj, Gjykata në lidhje me këtë çështje e urdhëron kreditorin me konkluzionin CP.nr.06/2014 të datës 15.01.2016, që në afat prej 7 ditësh, kësaj Gjykate t'i siguroj adresën e debitorit, e nëse nuk veprohet sipas udhëzimeve në konkluzion, gjykata do propozimin për përmbarim do ta konsideroj se është tërhequr, po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e ne qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtresa do të hidhet poshtë.

Kreditori me datë 19.01.2016 e ka pranuar konkluzionin në fjalë, mirëpo në afatin e paraparë prej 7 dite, nga shkresat e lëndës rezulton se i njëjti nuk ka vepruar sipas asaj që i është kërkuar me konkluzion.

Andaj, Gjykata duke e marrë parasysh se kreditori nuk veproi sipas konkluzionit, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u mbështetur ne normën e nenit 17 të LPP, e në lidhje me nenin 102 paragrafi 3 të LPK.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
CP.nr.935/2013, me datë 22.03.2024

GJYQTARI
Fuad Haliti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, brenda afatit prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate.